

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan-dega në Kamenicë, përmes gjyqtares së vetme Valbonë Dërvodeli, me procesmbajtësen Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.M. nga, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 397 parag. 5 lidhur me para.3 dhe 1 të KPK-së, të cilin e përfaqësonte me autorizim av. S.M. nga ..., duke vendosur sipas aktakuzës së PPK-së në Gjiilan PP.nr.27/2012 të dt.21.02.2012, në shqyrtimin e mbajtur gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Esat Ademi, të akuzuarit A.M. si dhe mbrojtësit me autorizim av.S.M. më datë 07.12.2016 komunikoi, ndërsa më datë 23.12.2016 përpiloi këtë,

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i ,

A.M., në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i padënuar më parë për veprë penale, nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse më datë 28.02.2012, rreth orës 19.30 h, në rrugën rajonale në relacionin, në dalje të, nga pa kujdesia, ka shkelur Ligjin mbi trafikun publik, përkatësisht dispozitën e nenit 54.1 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacion rrugor, duke rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë me vëllim të madh, në atë mënyrë që, gjatë ngasjes së automjetit të markës “...”, me targa regjistrimi numri i tabelave ..., nuk ia ka përshtatur shpejtësinë e ngasjes së automjetit gjendjes dhe kushteve të rrugës si: pjesa e rrugës në vendin e banuar, dukshmëria-pamja e zvogëluar dhe lagështisë në rrugë, ashtu që me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit, e godet këmbësorin, tani të ndjerin N.H. nga ... i cili në ato çaste ishte duke ecur me bashkëshorten e tij, në shiritin lëvizës të automjeteve djathtas, në të njëjtin drejtim të lëvizjes të cilin nga goditja e gjuan në rrugë me ç’rast i shkakton lëndime vdekjeprurëse nga të cilat ndërron jetën menjëherë pas dërgimit për ndihmë mjekësore në shtëpinë e shëndetit në Kamenicë.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 parag. 5 lidhur me parag. 3 dhe 1 të KPK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 41, 45, 47, 73, 75, 76 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarin,

E g j y k o n

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit do t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në kuptim të nenit 47 të KPRK-së, ashtu që shumën e përgjithshëm prej 3500 € do ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në qoftë se dënimi me gjobë nuk do të paguhet atëherë do të ekzekutohet dënimi me burg.

Të akuzuarit koha e kaluar në paraburgim nga data 30.01.2012 deri më datë 10.02.2012, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Të pandehurit A.M. i kthehet dorëzania në shumë prej 5000 €, i caktuar sipas aktvendimit PPr.nr.9/2012, të datës 10.02.2012, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara SH.H., nga, u deklarua se kërkesën pasurore-juridike e ka realizuar nga kompania e sigurimeve.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, për ekspertizën e komunikacionit të paguaj shumën prej 81.76 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi

A r s y e t i m

Prokuroria Komonale në Gjilan, me aktakuzën PP.nr.27/2012 të dt.21.02.2012, ka akuzuar A.M. nga, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 parag.5 lidhur me para. 3 dhe 1 të KPRK-së, pran të cilës ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që i akuzuari të deklarohet fajtor dhe të dënohet në përputhje me ligjin.

E dëmtuara SH.H. në fjalën e saj përfundimtare deklaroi se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale, ndërsa kompensimin e dëmit e kanë realizuar përmes kompanisë së sigurimeve .

I akuzuari A.M. në mbrojtjen e tij nuk ka kontestuar faktin se ditën konkrete gjatë drejtimit të veturës në fshatin Koretin ka pasur aksident komunikacioni, këmbësorin tani të

ndjerin e ka parë përafërsisht në një distancë prej 5 metrave, për shkak të kësaj distance të afërt nuk ka mundur ta përdorë frenin, gjatë lëvizjes me veturë ka qenë dimër, errët, rruga e rrëshqitshme ndërsa në momentin kritikë nuk i kujtohet sa ka qenë shpejtësia e lëvizjes, në kohën tepër të shkurtës që ka pasur në dispozicion është munduar t'i shmanget aksidentit mirëpo fatkeqësisht nuk ka mundur, e me këtë rast e ka goditur këmbësorin, pas goditjes menjëherë është ofruar te tani viktimia i njëjti ende ka pasur puls dhe për këtë me veturën e tij e ka dërguar në QKMF në, pasi të njëjtin e ka dërguar në QKMF në ju është ofruar bashkëshortes së viktimit, për ti ofruar ndihmë morale e më pastaj është dorëzuar në polici, derisa ka qenë nën masën e paraburgimit është informuar nga familjarët se të njëjtit kanë qenë në varrim, ndihet shumë keq për rastin që ka ndodhur u ka kërkuar falje familjarëve të të ndjerit atëherë dhe tani, njëherit ka vizituar djalin e të ndjerit në me qëllim që ti shprehë ngushëllime dhe falje, duke i thënë të njëjtit se nëse familja ka nevojë për ndihmë materiale është në gjendje t'ju ndihmojë, edhe tani shprehë gatishmëri të vizitojë familjarët dhe varrin e të ndjerit.

Mbrojtësi me autorizim av. S.M. në fjalën e tij përfundimtare theksoi se, edhe pas administrimit të të gjitha provave, pjesërisht është vërtetuar teza e aktakuzës edhe atë duke marr për bazë mendimin e ekspertit të komunikacionit ku sipas kësaj ekspertize në rastin konkret përgjegjësia që ka ndodhur ky aksident është përgjegjësi e dy anshme. Andaj kërkon nga gjykata që këto prova që disponon ti analizon me përgjegjësi të plotë ashtu që gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese të parapara në nenin 76 të KPRK-së edhe atë : i mbrojturi i tij ka pranuar pjesërisht fajësinë, ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë, me familjen e të dëmtuarit janë pajtuar, vepra është kryer nga pa kujdesia, moshën relativisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale , sa i përket dënimit nëse gjykata vlerëson se të mbrojturit të tij duhet ti shqiptohet një dënim me burg i propozon gjykatës që ta ketë parasysh dispozitën ligjore të nenit 47 të KPRK-së, ashtu që dënimi me burg t'i zëvendësohet në dënim me gjobë.

I akuzuari A.M. mbetet pranë fjalës përfundimtare të avokatit me autorizim S.M.

Gjykata në procedurën provuese ka dëgjuar të dëmtuarën në cilësi të dëshmitares, SH.H., dëshmitarin XH.Z., provat bashkangjitur lëndës: raportin e aksidentit të datës 28.01.2012 ora 19.30 min me numër CR-3009-027-12 bashkangjitur përshkrimin e vendit të ngjarjes, skica e vendit të ngjarjes e njësisë së trafikut Rajonal Gjilan me numër CR-3009-027-12, është shikuar foto dokumentacioni bashkangjitur lëndës me numër EN- 48332412155, polisa e sigurimit të veturës me numër 0002804512 e datës 14.03.2011, për automjetin e markës “marka e automjetit”

kombi, raporti me numër 1103 të datës 28.01.2012 mbi konstatimin e vdekjes i shërbimit të urgjencës në Kamenicë, raporti mbi automjetin e tërhequr me datë dhe numër të njëjtë, ekspertiza e komunikacionit e punuar nga eksperti i komunikacionit shtator 2016.

E dëmtuara në cilësi të dëshmitares SH.H. në dëshminë e saj ka deklaruar, natën konkrete së bashku me bashkëshortin kanë dalur nga shtëpia në duke ecur përkrah njëri tjetrit edhe ate dora e sajë në xhepin e jaknes të bashkëshortit dhe pa mbërri tek pompa e benzinës, pa dëgjuar fare zhurmën e veturës bashkëshorti është goditur nga një veturë e më atë rast është gjuajtur në një largësi prej 8 metrave , lëvizja e tyre ka qenë në anën e djathtë në drejtim të lëvizjes, dukshmëria ka qenë relativisht e mirë, *pjesa e cila është shfrytëzuar si tretuar ka qenë e mbuluar me borë, bashkëshorti ka pasur të veshur jakne ngjyrë të zezë , ndërsa pantollonat kanë qenë farmerka, me vete nuk kanë pasur shkrepsë apo shenjë sinjalizuese.* Pas aksidentit vozitësi është ndalur dhe me veturën e tij bashkëshortin e kanë dërguar në QKMF në ..., ku jemi informuar nga doktorët se i aksidentuari paska vdekur në vend ndërsa tani vetëm po e liron ajrin. I akuzuari e ka ftuar në telefon nga ...për ti shprehur ngushëllime njëherit i njëjti ka qenë edhe te djali i saj për t'i shprehur ngushëllime dhe për ti kërkuar falje, me të akuzuarin përmes njerëzve janë pajtuar.

Dëshmitari XH.Z. në dëshminë e tij ka deklaruar, pasi kanë marr informacionin se në fshatin Koretin ka ndodhur një aksident me pasoja fatale, menjëherë janë dalur në vend të ngjarjes dhe ka konstatuar se: rruga ishte rajonale dhe e asfaltuar , gjerësia ishte 5.80 metra , rrugë e hapur për lëvizjen e automjeteve ndërsa si tërësi rruga me dy trotuare ka qenë 9.70 metra , mirëpo trotuari ka qenë i mbuluar me një trashësi të borës rrethe 25 cm, *në trotuar nuk ka pasur gjurmë të lëvizjeve të këmbësorëve e as të automjeteve,* sipas hetimeve të bëra në vend të ngjarjes aksidenti është zhvilluar në tri faza, faza e parë në pjesën e parë të veturës të anës së djathtë është goditur viktime në këmbën e majtë nga mbrapa, faza e dytë hedhja nëpër kapak të motorit dhe në mbrojtësin ku edhe i ka gjurmët vetura e që mendohet ka qenë edhe momenti fatal, ndërsa faza e tretë është hedhja në tokë, viktimi ka pasur të veshura rroba të errëta (të zeza), *dukshmëria ka qenë errët, nuk ka pasur ndriçim publik,* i akuzuari sipas ekzaminimit nuk ka qenë nën ndikimin e alkoolit apo substancave psikotropike, në vendin ku ka ndodhur aksidenti nuk ka pasur gjurmë të frenimit por vetëm gjurmë të ndaljes, *këmbësorët kanë qenë duke lëvizur në shiritin lëvizës të automjeteve.*

Eksperti i komunikacionit A.T. në deklaratën e tij ka theksuar se, në bazë të dokumentacionit të ofruar nga gjykata e duke u bazuar në literaturën profesionale shpejtësia e lëvizjes në të cilin është goditur këmbësori sillet diku 55 km/h, këmbësori është goditur me

pjesën e përparme të djathtë të dritës e pas goditjes është përplasur në xhamin errëmbrojtës , ndërsa në lokacionin ku është shkaktuar aksidenti shpejtësia e lëvizjes ka përfunduar 50 km/h kufizimi, aksidenti ka ndodhur pasi ka përfunduar tabela e vendbanimit- kufizimi i shpejtësisë, rruga e asfaltuar e dedikuar për automjetet ka qenë pa borë, këmbësori ka lëvizur në rrugën automobilistike djathtas (jo në tretuar), dhe si përfundim ka konstatuar se *deri te aksidenti ka ardhur me lëshimet e të dy pjesëmarrësve në komunikacion si të vozitësit ashtu edhe të këmbësorit ashtu siç ceket edhe në ekspertizën e komunikacionit.*

Gjykata duke vlerësuar të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku në përputhje me nenin 8 dhe 361 të KPPRK-së, për veprën penale të përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit ka vërtetuar këtë gjendje të fakteve: nga ekspertiza e komunikacionit e punuar nga Ing. A.T, vërtetohet se deri te aksidenti ka ardhur me lëshimet e bëra nga ana e këmbësorit N.H. duke i kontribuar aksidentit me lëvizje në rrugën automobilistike dhe duke mos mbajtur anën e majtë sikurse që ka qenë i obliguar sipas ligjit, ndërsa lëshimet e ngasësit të automobilin janë: mos kujdesi gjatë ngasjes së automjetit duke mos reaguuar me kohë për evitimin e aksidentit edhe pse kushtet e pamjes kanë qenë të mjaftueshme për evitimin e aksidentit, gjithashtu nga deklarata e të dëmtuarës dhe dëshmitarit u vërtetua se tani i ndjeri është goditur nga vetura të cilën e ngiste tani i akuzuari, i ndjeri gjatë lëvizjes në rrugën automobilistike (pjesa e shfrytëzuar si tretuar ka qenë e mbuluar me borë) ka pasur rroba ngjyrë të errët, këmbësorit tani i ndjeri dhe e dëmtuara gjatë lëvizjes nuk kanë pasur shkrepsë apo shenjë sinjalizuese , nuk kanë ecur në anën e majtë ashtu siç është e paraparë me ligj, kanë ecur përkrah njëri tjetrit.

Pra në këtë çështje penalo juridike, nuk janë kontestuese faktet e cekura më lartë se deri te aksidenti ka ardhur me lëshimin e bërë nga ana e këmbësorit tani i ndjerë dhe lëshimet e bëra në komunikacion të ngasësit të veturës.

Gjykata në tërësi i ka kushtuar besim ekspertizës së komunikacionit e njëjta është bërë në mënyrë profesionale, është sqaruar në detaje si ka ardhur deri te aksidenti dhe nga të gjeturat e ekspertizës ka ardhur në përfundim se shkaktar të këtij aksidenti kanë qenë të dy pjesëmarrësit në komunikacion si këmbësori tani i ndjerë po ashtu edhe ngasësi i veturës tani i akuzuari A.M. e njëjta ishte në përputhje dhe nuk ra ndesh me deklarata e dëshmitarëve.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit i njëjti ka pranuar fajësinë pjesërisht edhe atë për lëshimet që i ka bërë në komunikacion, mirëpo nuk ka pranuar se vetëm me lëshimet e tij ka ardhur deri te aksidenti.

Nga faktet që u parashtruan më parë , qartë rezulton se janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 parag. 5 lidhur me parag.3 dhe 1 të KPK-së.

Me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ndaj të akuzuarit për veprën penale që e ka kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 74 të KPK-së, ndikojnë që dënimi të jetë më i lehtë apo më i rëndë, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori: sjelljen korrekte në gjykatore, mbajtës i familjes, nuk ka qenë i dënuar më parë dhe nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale, bashkëpunues me gjykatën, moshën relativisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale, vepra penale e kryer nga pa kujdesia, ndihmën e ofruar tani të ndjerit, ka ftuar të dëmtuarën për t'i shprehur ngushëllime , gjithashtu i akuzuari ka qenë tek djali i të ndjerit nëpër ti shprehur ngushëllime dhe për ti kërkuar falje, e dëmtuara nuk iu ka bashkangjitur ndjekjes penale, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese ndaj ti nuk gjeti, . andaj gjykata vlerëson se me shqiptimin e dënimit me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, në kuptim të nenit 47 të KPK-së, i zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 3500 (tremijë e pesëqind) €, do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar në neni, 41 , të KPK-së, andaj bazueshëm mund të pritët që ky dënim do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të akuzuarit, sikundër që do t'i kontribuojnë disiplinës dhe përgjegjësisë më të madhe në përgjithësi.

E dëmtuara SH.H., nga, u deklarua se kërkesën pasurore-juridike e ka realizuar nga kompania e sigurimeve.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 453 lidhur me nenin 450 të KPPRK-së.

Gjykata nga të cekurat më lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN- DEGA NE KAMENICE,

Procesmbajtësja

Gjyqtarja

Emine Zubaku,d,v

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej
15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së
Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.